



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 17, date 26/04/2004

**“PËR
DETYRIMET FINANCIARE TË BASHKISË TIRANË NDAJ PERSONAVE
TË TRETË QË LIDHEN
ME VENDIME GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË”**

Mbështetur në Ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32, gërma “g”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2004”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën dhe shumat përkatëse të detyrimeve financiare të Bashkisë Tiranë, që lidhen me detyrimet gjyqësore të formës së prerë ndaj personave të tretë, sipas tabelës Nr.1 dhe Nr.2 bashkëngjitur.
2. Efektet financiare në shumën 19.097.198 lekë të përballohen nga fondi i vënë në dispozicion, për detyrimet gjyqësore, miratuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2004.
3. Shuma prej 433.232 lekësh, për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore dhe taksën e ekzekutimit, të përballohen nga fondi i shpenzimeve operative të Aparatit të Bashkisë.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Drejtoria Juridike që të verifikojë përgjegjësitë personale administrative apo penale dhe t'i propozojë Këshillit Bashkiak marrjen e masave në përputhje me shkeljet e konstatuara.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI